



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2019:092207  
Datë: 04.04.2024  
Numri i dokumentit: 05544373

P.nr.221/2023

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri - Islami, me bashkëpunëtoren profesionale Edita Koliqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M.A, për shkak të veprës penale: Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP-I.nr.364/2015, të datës 25.04.2018, pas mbajtjes së seancës së shqyrimit gjyqësor me datë 12.03.2024, në mungesë të Prokurorit të Shtetit Ajtene Zoni, të akuzuarit M.A, si dhe mbrojtësit të akuzuarit av.Besim Abdullahu me datë 12.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 04.04.2024, përpiloj këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

M.A, nga i ati H..., e ëma I..., e vajzërisë A..., i lindur me datë ....., në fshatin G..., Komuna e P..., me adresë të vendbanimit në rrugën “...”, në P..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, pensionist, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të identifikimit ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:**

Me datë 23.08.2015 rreth orës 13:00 minuta në fsh.Rezhanë, Komuna e Mitrovicës, në malet e Shalës së Bajgorës ka mbajt në pronësi, kontroll ose posedim armën në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët dhe atë pushkën M-48, me numër serik .... si dhe pesë (5) fishekë

të së njëjtës armë, e cila armë i është gjetur në ulësen e pasme të automjetit të tij “Mercedes Benz” xhip ngjyrë e gjelbër, ndërsa pesë fishek i janë gjetur të pandehurit në xhepin e përparëm të pantallonave deri sa ishte në veturën e tij me rastin e kontrollimit nga ana e policisë, e të cilën armë e kishte marrë për shkaqe sigurie nga ndonjë bishë e malit,

-Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, (Kodi Penal i Republikës së Kosovës 04/L-082).

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 43, 46, 73,74, lidhur me nenin 374 par.1 të KPRK-së, dhe neneve: 364, 276, 449, 452 të KPP-së, të akuzuarit, i:

## S H Q I P T O N

- I. DËNIM ME GJOBË në shumën prej 300 € (treqind euro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarit, dënimin me gjobë do të i'a zëvendësoj në dënim me burgim, duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.
- II. Në mbështetje të nenit 374 par.3 të KPRK-së e lidhur me nenin 276 par.2, nën-par 2.1 të KPP-së, ndaj të pandehurit URDHËROHET, konfiskimi i përhershëm i sendeve dhe atë:
  - a.Një armë – pushkë M-48 me numër serik .... dhe pesë fishek.
  - b.Urdhërohet Policia e Kosovës që armën – pushkën së bashku me fishekët t'i shkatërroj, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.
- III. OBLIGOHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimate të krimtit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP-I.nr.364/2015, të datës 25.04.2018, kundër të akuzuarit M.A, për shkak të veprës penale: Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 12.03.2024, në të cilën ka prezantuar Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni, i akuzuari M.A dhe mbrojtësi i tij av.Besim Abdullahu.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, Gjyqtarja e vetme gjykuese e ka njoftuar të pandehurin lidhur me të drejtat e tij në këtë çështje penale dhe pasi që është bindur se i pandehuri i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës, të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i pandehuri lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se ndjehet fajtor dhe se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare, dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, konform dispozitave ligjore te nenit 242 të KPP-së, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i propozon gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj një dënim sipas ligjit duke i pasur parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Mbrojtësi i të pandehurit M.A, av.Besim Abdullahu lidhur me pranimin e fajësisë, i ka propozuar gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë, pasi është bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimit të mjaftueshëm edhe me të si mbrojtës. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i propozon gjykatës që të ketë parasysh te gjitha rrethanat lehtesuse faktin se i njehti eshte i moshes se shtyer dhe nuk ka rene ndonjehere ndesh me ligjin, armen te cilen ai ka poseduari nuk e ka e prdorur dhe e njejta ka qene me leje por me kalimin e kohes per shkak te pakujdesise se tij e njejta nuk

eshte vazhduar po ashtu te merret parasysh edhe fakti se i njejti deri me tani ka bashkëpunuar me gjykatën, është i gjendjes jo te mire ekonomike dhe per kete i propozojme gjykates ti shqiptoj nje dënim me te butë, konsiderojmë se nuk ka rrethane renduese ne kete çeshtje.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i akuzuari, e në mbështetje të nenit 322 të KPP-së, në këtë drejtim ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e fajësisë për të akuzuarin.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2015-BC-1046, i datës 23.08.2015; Prosesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit A.B i datës 23.08.2015; Prosesverbali i marrjes në pyetje për të pandehurin M.A në SP - Mitrovicë i datës 23.09.2015 dhe në P.Th Mitrovicë i datës 23.04.2018; Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve; Raporti i oficerit i datës 23.08.2015 dhe Raporti i policit hetues i datës 26.02.2018; si dhe shkresat tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i' u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsyë gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lartë, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari M.A ka kryer veprën penale: Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, e për të cilën vepër është paraparë dënim me gjobë deri në shtatëmijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së. Gjykata, si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari, i njëjtë ka treguar sjellje të mirë në gjykatë, si dhe faktin se nga kryerja e veprës penale ka kaluar një kohë e gjatë më shumë se tetë (8) vite. Ndërsa, rrethana rënduese gjykata vlerësoj peshën dhe rrezikshmérinë e kësaj vepre penale.

Gjykata vlerëson se dënim i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënim i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit 374 par.3 të KPRK-së e lidhur me nenin 276 par.2, nën-par 2.1 të KPP-së, ka bërë konfiskimin e detyrueshëm e të përhershëm të armës - pushkë M-48 me numër serik ..... dhe pesë fishek.

Gjykata rikujton se i pandehuri s'kishte leje e as autorizim për posedimin e armës. Në anën tjetër sendet e lartcekura bëjnë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike nga këto arsyet gjykata ka vendosur t'i konfiskoj përherë dhe të njëjtat ka urdhëruar që të shkatërrohen. Gjykata vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet ligjore për konfiskimin e përhershëm të armës sipas nenit 374 par.3 KPRK-ës, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm, konfiskimi ishte propozuar në aktakuzë – dispozita e lartcekur e këtij Kodi, përcakton shprehimisht konfiskimin e detyrueshëm të saj.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 lidhur me par.1 dhe nenit 452 par. 1 të KPPK-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimate të krimtit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimate të Krimtit.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 364, 276, 449, 452 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**  
**P.nr.221/2023, të datës: 04.04.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale**  
**Edita Koliqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**  
**Qëndresa Tahiri - Islami**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankesë në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.